



# "QEVERI - KOMPANI, ËSHTË BËRË VONË. KTHJELLUNI OSE LAMTUMIRË!"



Në Ditën Ndërkombëtare të Punës në Kosovë është shprehur pakënaqësi sa i përket trajtimit të pabarabartë të punonjësve dhe shkallës së lartë të papunësisë në vend. "Qeveri - Kompani, është bërë vonë. Kthjelluni ose

lamtumirë" ishte mesazhi kryesor i pankartës që mbanin në duar punëtorët protestues, duke theksuar se punëtori në Kosovë llogaritet si vegël dhe jo si aset. Kryeministri Albin Kurti është lavdëruar se si qeverisje e re kanë

ndërmarrë një sërë hapash, vendimesh e iniciativash ligjore që prekin jetën e punëtorëve. E opozita ka drejtuar akuza në drejtim të qeverisë, duke theksuar se dhjetëra mijëra të rinj janë larguar në dy vitet e fundit

## 33 VJET NGA KUVENDI I VERRAVE TË LLUKËS TË PAJTIMIT TË GJAQEVË

FAQE 6



## LLADROVCI TAKON THAÇIN DHE VESELIN NË HAGË: KOSOVA KURRË NUK DO TË MBETET PA HISTORI

FAQE 3



## AKTUALE



### ERDOGANI: FORCAT TURKE VRANË SHEFIN E IS-it NË SIRI

F. 2

### KURTI: NUK DO TA LEJOJMË KRIJIMIN E REPUBLIKA SRPSKA NË VERI

F. 5

### TAHIRI: MODELI I STATUTIT TË ASOCIACIONIT DO TË NDIKOJË NË FUNKSIONALITETIN E SHTETIT TË KOSOVËS DHE NË FATIN E KUFIJVE NË BALLKAN

F. 4

## EKONOMI



### ASK-ja: NË TRE MUAJT E PARË TË KËTIJ VITI U HAPËN MBI 3 000 BIZNESE

F. 7

### FALIMENTON EDHE NJË TJETËR BANKË E MADHE AMERIKANE

F. 7

## SPORT



### KUMBULLA: DO TË RIKTHEHEM EDHE MË I FORTË

F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Mqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Franca kritikohet për diskriminim racor dhe dhunë policore

PARIS, 1 MAJ - Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut kritikoi të hënën, më 1 maj, mungesën e supozuar të respektimit të të drejtave të njeriut në Francë, duke deklaruar se ka sulme ndaj emigrantëve, diskriminim racor dhe dhunë policore.

Këshilli i OKB-së diskutoi për situatën e të drejtave të njeriut në Francë për më shumë se tri orë. Diskutimet e tilla janë pjesë e procedurave të cilave u nënshtrohen rregullisht çdo katër vjet të gjitha shtetet anëtare të OKB-së.

Një numër i madh vendesh, përfshirë ShBA-në dhe Tunizinë, i bënë thirrje Francës t'i shtojë

përpjekjet në luftën kundër dhunës dhe diskriminimit racor. "Ne rekomandojmë që Franca t'i shtojë përpjekjet e saj në luftën kundër krimeve dhe kërcënimeve për dhunë me motive të urrejtjes fetare, si antisemitizmi dhe urrejtja antimuslimane", tha përfaqësuesja e ShBA-së në këtë organ të OKB-së, Kelly Billingsley. Delegacioni kinez tha se kishte një rritje të racizmit dhe ksenofobisë dhe i bëri thirrje Francës ta ndalojë marrjen e "masave që shkelin të drejtat e emigrantëve".

Brazili dhe Japonia kritikuan diskriminimin racor, ndërsa Afrika e Jugut u bëri thirrje

autoriteteve franceze "ta sigurojnë një hetim të paanshëm në të gjitha rastet e incidenteve raciste që përfshijnë zyrtarë policorë".

Gjatë muajve të fundit në Francë janë shumëfishuar kritikët kundër përdorimit të forcës që konsiderohet e tepruar ndaj protestuesve që kundërshtojnë reformën e pensioneve.

Delegacioni francez njoftoi në Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut se "përdorimi i forcës është rreptësisht i mbikëqyruar, i kontrolluar dhe, në rast të sjelljes së papërshtatshme, i sanksionuar", ndërsa shtoi se "Franca dënon çdo lloj të profilizimit racor".



## Erdogan: Forcat turke vranë shefin e IS-it në Siri

ANKARA, 1 MAJ - Forcat turke e kanë vranë liderin e supozuar të grupit të Shtetit Islamik (IS) gjatë një operacioni në Siri, tha mbrëmjen e së dielës, më 30 prill, presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan.

Presidenti Erdogan tha gjatë një intervistë për televizionin turk TRT se lideri i IS-it, i njohur si Abu Hussein al-Qurayshi, u vra në një sulm të kryer të shtunën, më 29 prill.

Erdogani tha se agjencia turke e inteligjencës, MIT, kishte qenë duke e ndjekur atë "për një kohë të gjatë". "Ne do ta vazhdojmë luftën tonë kundër organizatave terroriste pa diskriminuar asnjërin prej tyre", tha Erdogan gjatë intervistës.

Turqia ka kryer operacione të shumta kundër IS-it dhe grupeve kurde përgjatë kufirit sirian, duke kapur ose vranë



militantë të dyshuar. Turqia kontrollon pjesë të mëdha të territorit në Sirinë veriore pas një serie inkursionesh tokësore për t'i larguar grupet kurde nga kufiri turko-sirian.

Abu Hussein al-Qurayshi u emërua udhëheqës i grupit militant pasi kreu i tij i mëparshëm u vra në tetor. Një zëdhënës i IS-it e quajti atë "një nga luftëtarët veteranë dhe një

nga djemtë besnikë të Shtetit Islamik".

Ai mori drejtimin e IS-it në kohën kur grupi ekstremist ka humbur kontrollin e territorit që dikur mbante në Irak dhe Siri. Megjithatë, grupi ishte përpjekur të aktivizohej sërish, duke kryer disa sulme vdekjeprurëse në të dyja vendet.

Themeluesi i IS-it, Abu Bakral-Baghdadi, ishte thënë se e kishte vranë pasi ishte rrethuar nga forcat amerikane në një sulm në veriperëndim të Sirisë në tetor të vitit 2019. Pasardhësi i tij, Abu Ibrahim al-Hashimial-Qurayshi, u vra në një sulm të ngjashëm në shkurt 2022. Ai u pasua nga Abual-Hassanal-Hashimial-Qurayshi, i cili, sipas ushtrisë amerikane, u vra në mes të tetorit në një operacion nga rebelët sirianë në provincën

jugore të Sirisë, Daraa.

Grupi IS u shpëput nga al-Kaida rreth një dekadë më parë dhe pastaj arriti të kontrollojë pjesë të mëdha të Sirisë veriore dhe lindore, si dhe Irakun verior dhe perëndimor. Në vitin 2014, ekstremistët shpallën të ashtuquajturin kalifat, duke tërhequr mbështetës nga e gjithë bota.

Në vitet në vazhdim, ata pretenduan se ishin përgjegjës sulme të shumta në të gjithë botën që vranë dhe plagosën qindra njerëz, përpara se të sulmoheshin nga vende të ndryshme të botës. Në mars të vitit 2019, luftëtarët sirianë të mbështetur nga SHBA-ja morën kontrollin e pjesës së fundit të territorit që dikur mbanin ekstremistët në provincën lindore të Sirisë, Deir-el-Zour, që kufizohet me Irakun.

## Një shpërthim e nxjerrë nga shinat një tren në kufirin rus

BRYANSK, 1 MAJ - Një shpërthim në rajonin kufitar të Ruisë, Bryansk, bëri që një tren mallrash të dalë nga shinat të hënën, më 1 maj, thanë autoritetet.

Governatori lokal Alexander Bogomaz tha se një mjet shpërthyes eksplodoi përgjatë linjës hekurudhore Bryansk - Unecha.

Incidenti, i cili ndodhi në orën 10:17 sipas kohës lokale, bëri që lokomotiva të merrte flakë dhe shtatë vagonë mallrash të dalin nga shinat, sipas shërbimit hekurudhor të Ruisë.

Në këtë rajon, i cili kufizohet me Ukrainën dhe Bjellorusinë, janë

regjistruar disa incidente qëkur Rusia nisi pushtimin e paprovuar të Ruisë.

Treni raportohet se transportonte produkte nafte dhe lëndë druri. Nuk raportohet për të lënduar. "Një mjet shpërthyes i paidentifikuar shpërtheu në kilometrin e 136 në linjën hekurudhore Bryansk - Unecha, duke nxjerrë nga shinat një tren mallrash", tha Bogomaz në një postim në "Telegram". Fotografitë dhe videot e shpërndara në rrjete sociale duket se tregojnë vagonë të rrëzuar anash, ndërsa shtëllunga tymi ngriheshin në ajër.

Të shtunën, më 29 prill, Bogomaz tha se katër persona vdiqën pasi Ukraina bombardoi fshatin Suzemka, rreth 12 kilometra në veri të kufirit të Ruisë me Ukrainën.

Ndërkohë, Rusia ka gjuajtur raketa në të gjithë Ukrainën në sulmin e saj të dytë para agimit në tre ditët e fundit.

Sulmet shkaktuan dëme të shumta në një qendër logjistike në Pavlohrad, pranë qytetit Dnjepër në Ukrainën qendrore. Dhjetëra shtëpi u shkatërruan dhe 34 persona u plagosën. Ushtria ukrainase tha se kishte rrëzuar 15 nga 18 raketat e lëshuara nga forcat ruse.



# Mjekë të huaj punojnë në Kosovë pa licencë

PRISHTINË, 1 MAJ - Edhe pse e ndaluar me ligj, në Kosovë ka mjekë të huaj që ushtrojnë veprimtaritë e tyre pa u lajmëruar dhe pa u licencuar nga institucioni përkatës. Për këtë shkelje, Inspektorati Shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë ka shqiptuar në vitin 2022 së paku 26 gjoja.

Në një deklaratë dhënë "Radios Evropa e Lirë", thuhet se "Inspektorati Shëndetësor ka hasur në raste të ofrimit të shërbimit shëndetësor nga mjekë jokosovarë pa vendim për angazhim të përkohshëm nga Bordi Qendror për Regjistrim dhe Licencim nga Ministria e Shëndetësisë". Sipas Ligjit për Dhënie të Lejeve dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Kosovë, secili person që hyn në Kosovë për punë duhet ta ketë lejen e qëndrimit dhe atë të punës.

Një Udhëzim Administrativ për licencimin e përkohshëm të profesionistëve shëndetësorë, i nxjerrë në tetor të vitit të kaluar, i obligon institucionet shëndetësore, publike dhe private, që të paraqesin kërkesë për leje apo licencim, në rast se angazhojnë profesionistë të huaj shëndetësorë.

Leja dhe licencimi bëhen nga Bordi për Regjistrim dhe Licencim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe monitorohet nga Inspektorati Shëndetësor. Në bazë të Udhëzimit Administrativ, institucionet shëndetësore që kanë të punësuar profesionistë të huaj

shëndetësorë pa leje, gjobiten 5 000 deri në 8 000 euro. Mjeku ose ndonjë profesionist tjetër shëndetësor i huaj, që punon pa leje pune, mund të gjobitet 500 deri në 1 500 euro.

Nga Inspektorati Shëndetësor tregojnë për REL-in se rastet zbulohen zakonisht gjatë bisedave me pacientë, të cilët i përshkruajnë mjekët dhe i japin emrat e tyre, por ata emra nuk figurojnë në librin e shënimeve të institucionit shëndetësor. Mjekët nga shteti i Turqisë përmenden në mënyrë të veçantë.

Nga Oda e Mjekëve të Kosovës shprehin shqetësim për mënyrën sesi funksionojnë dhe licencohen mjekët ndërkombëtarë në Kosovë.

Kryetari i kësaj ode, Pleurat Sejdiu, thotë se mjekët e huaj, të cilët kryejnë shërbime në Kosovë, sipas ligjit, duhet të anëtarësohen fillimisht në këtë odë, por, sipas tij, ata nuk e bëjnë një gjë të tillë. "Jemi të vetmit në Evropë dhe më gjerë, ku licencimin e tyre [mjekëve të huaj] e bën Ministria e Shëndetësisë dhe jo Oda. Nuk kemi të dhëna rreth aktivitetit të tyre. Me Ligjin e shëndetësisë, ata duhet të anëtarësohen në Odë, por me Udhëzimin Administrativ ky obligim është hequr", thotë Sejdiu për Radion Evropa e Lirë. "Inspektorati Shëndetësor, në këtë aspekt, nuk bashkëpunon me ne", shton ai.

REL-i kontaktoi tri spitale private në Kosovë, për të cilat është në dijeni se herë pas here



angazhojnë mjekë të huaj për të dhënë shërbime, por nga asnjëri prej tyre nuk pranuan të flasin për këtë temë,

Bujar Vitija, kryeredaktor i gazetës "Shneta" që raporton për sektorin e shëndetësisë në Kosovë, thotë se mjekët e huaj që ofrojnë shërbime në Kosovë, në shumë raste, bëjnë shkelje ligjore duke mos i plotësuar të gjitha kriteret për licencim, ose duke mos u licencuar fare në Ministrinë e Shëndetësisë. "Në disa raste, këta mjekë vijnë për të rekrutuar pacientë për t'i trajtuar në vendet e tyre", thotë ai, pa specifikuar më shumë. "Disa

prej kriterëve që nuk i plotësojnë, janë: mosnjohja e gjuhës shqipe, mosanëtarësimi në Odën e Mjekëve, mosregjistrimi për licencim në Ministrinë e Shëndetësisë...", shton Vitija.

Sipas tij, Ministria e Shëndetësisë duhet t'i rrisë kapacitetet e Inspektoratit Shëndetësor dhe të kërkojë më shumë përgjegjësi në monitorimin dhe mbikëqyrjen e këtyre rasteve. "Ata [mjekët e huaj] vijnë si turistë në Kosovë, zhvatin pacientët kosovarë dhe në shumë raste kalojnë pa u vërejtur fare nga Inspektorati Shëndetësor", thotë

Vitija.

Në Inspektoratin Shëndetësor punojnë gjithsejtë 13 zyrtarë: kryeinspektori, asistenti ekzekutiv, zyrtari i arkivit dhe dhjetë inspektorë shëndetësorë.

Kosova, viteve të fundit, është duke u përballur me mungesë mjekësh dhe infermierësh, pasi një numër i tyre ka migruar kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian.

Ministria e Shëndetësisë e profesionistëve të fushave të ndryshme mjekësore në mesin e mërgatës shqiptare, që të angazhohen dhe punojnë në institucionet shëndetësore publike të Kosovës.

# Lladrovci takon Thaçin dhe Veselin në Hagë: Kosova kurrë nuk do të mbetet pa histori

HAGË, 1 MAJ - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka vizituar të hënën në Hagë ish-kryerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli. Lladrovci në "Instagram" ka përshkruar takimin me shumë emocione. Siç ka theksuar ai, në fillim të takimit nuk ka ditur as nga t'ia fillojë. "Njohja ime me ish-presidentin, kryeministrin, drejtorin e Drejtorisë Politike të UÇK-së, është shumë e hershme. Aq e hershme sa në fillim të takimit nuk e dija as nga t'ia filloja. Mall i fuqishëm sa fryma më zihej dhe tërë një jetë më doli përpara. Më dolën përpara shokët që më nuk i kemi, shokët që e bënë historinë. Pastaj, u ktheva në realitet, kjo barrë e pashembullt që i është ngarkuar heronjve tanë të luftës dhe paqes është edhe një betejë që do ta bëjnë për Kosovën, edhe një betejë për kombin", ka shkruar Lladrovci.

Ai ka shtuar se "gjatë kohës sa qëndrova me Hashimin pata rastin t'i them se shpirti po na digjet për ta, ndjenjat po na vlojnë, por, kemi besim se gjithçka do të jetë në rregull dhe drejtësia do të triumfojë". "Shoku im Hashimi, ishte sikur i ditëve të

para të njohjes tonë, plotë energji, besim në veten dhe kauzën që përfaqëson, kauzën e drejtë të cilën ia ngarkoi historia - mbrojtjen e popullit të tij dhe shtetit që u krijua nga sakrificat mbinjerëzore e atdhetarëve dhe bota demokratike, në krye me NATO-n. Edhe një herë ia hoqi retë e zeza Kosovës", ka shkruar më tutje.

Kreu i Drenasit e ka përshkruar të vështirë edhe takimin me Kadri Veselin. "Ta kesh shok e mik Kadri Veselin, është bekim. Takimi ishte i vështirë, sepse, me jetën e tij dhe atdhetarizmin e kulluar, nuk e ka merituar as një minutë të jetë i penguar për ndërtimin dhe fuqizimin e shtetit të Kosovës. Si çdo herë, Kadriu flet me zemër, me plotë besim në rrjedhën e ngjarjeve të mira për Kosovën dhe popullin e saj, sepse, ne ishim në anën e duhur të historisë, ishim të brumosur me ndjenjat më humane përballë okupimit që domosdo duhej ndërprerë, me çdo çmim", ka pohuar ai.

Lladrovci ka theksuar se "takimi teorësh kaloi si tre minuta": "Ishte e pabesueshme se sa lehtë Kadriu e interpreton të tashmen dhe të ardhmen tonë euro-



atlantike, vlerat e shtetit tonë, të njerëzve tonë, durimin e tij dhe heroizmin e paparë që e cilëson çdo popull fisnik - sakrificën.

Ndarja ishte e rëndë, plumb, megjithatë, liria e shpirtit të tij është e pacenueshme, e ngjashme sikur e të gjithë

atdhetarëve tanë, të cilët ishin në gjendje të japin gjithçka për lirinë e Kosovës. Kosova kurrë nuk do të mbetet pa histori".



DITA E PUNËTORËVE SHËNOHET ME PROTESTA NË KOSOVË

## “Qeveri - Kompani, është bërë vonë. Kthjelluni ose lamtumirë!”

Në Ditën Ndërkombëtare të Punës në Kosovë është shprehur pakënaqësi sa i përket trajtimit të pabarabartë të punonjësve dhe shkallës së lartë të papunësisë në vend. “Qeveri - Kompani, është bërë vonë. Kthjelluni ose lamtumirë!” ishte mesazhi kryesor i pankartës që mbanin në duar punëtorët protestues, duke theksuar se punëtori në Kosovë llogaritet si vegël dhe jo si aset. Kryeministri Albin Kurti është lavdëruar se si qeverisje e re kanë ndërmarrë një sërë hapash, vendimesh e iniciativash ligjore që prekin jetën e punëtorëve. Opozita ka drejtuar akuza në drejtim të qeverisë, duke theksuar se dhjetëra mijëra të rinj u larguan në dy vitet e fundit

nënshkrim të marrëveshjes kolektive, trajtim të barabartë me punonjësit e sektorit publik, rritje të numrit të inspektorëve të punës si dhe krijim të një fondi për ata që humbin jetën në vend të punës. “Nuk do t’ju lusim më. Qeveri e nderuar, të mirat që jua kemi dhënë, sipas të gjitha gjasave, tani e tutje do t’i përfitojë dikush tjetër. Momenti i fundit që e keni humbur ju dhe ne, shpëtoni atë çfarë mund të shpëtohet, përndryshe realiteti është realitet, në vitin 2021 dhe 2022 na kanë ikur nga Kosova mbi 100 mijë punëtorë si këta që kemi përballë”, ka thënë kryetari i Sindikatës së Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi. Shoqata “Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist” nëpërmjet një parakalimi në qendër të Prishtinës shprehu pakënaqësinë me, siç u tha, trajtimin e pabarabartë të punonjësve dhe shkallën e lartë të papunësisë në vend. “Puna jashtë orarit, puna pa kontrata,

paga minimale prej 170 eurosh, vendet e pasigurta të punës, vdekjet, abuzimet, krimet seksuale nuk janë simptoma të një sistemi të keqmenaxhuar, përkundrazi janë pjesë e një sistemi të mirëdizajnuar i cili mbahet e rritet përmes pabarazisë, shtypjes dhe dhunës”, ka pohuar Bjeshka Guri nga kjo shoqatë. Brikena Hoxha nga Nisma e Kosovës për Stabilitet ka thënë të hënën se ndër sektorët me më së shumti probleme janë gastronomia dhe hoteleria. Ajo i bëri këto komente në një konferencë për medie, gjatë së cilës u njoftua për themelimin e shoqatave sindikale për këta dy sektorë, në bashkërendim me Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës. “Ne besojmë që me formalizim, me ofrim të kontratave të punës, me trajtim të dinjitetshëm në punë, punëtorët e të rinjtë e Kosovës do të qëndrojnë në Kosovë dhe do të kenë perspektivë dhe do të ketë

një zhvillim ekonomik edhe më të mirë”, tha ajo. Nënkryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Selatin Sadiku, tha se punëtori në Kosovë është llogaritur si vegël dhe jo si aset. “Pagat janë të mjerueshme e minimale, punëtorëve duhet t’u paguhet djersa, ta kenë një pagë të dinjitetshme që ta mbajnë veten dhe familjen. Duhet të punohet me Qeverinë e Kosovës në vazhdimësi që nëpërmjet inspektorëve të punës t’u krijohen kushte sa më të mira për punë me qëllimin e vetëm që të arrihet produktivitet”, është shprehur ai. PSD-ja, e cila drejtohet nga Dardan Molliqaj, ka theksuar se ndërkohë që kryeministri Kurti pushon, dispozitat e Ligjit të Punës shkelen çdo ditë nga pronarët e mëdhenj. “Pronarët me të cilët kryeministri jonë është miqësuar. Kur ishte në opozitë takohej e afrohej me sindikatat, sot i shanë e sulmon

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 1 MAJ** - Grupe punonjësish të sektorit privat në Kosovë protestuan të hënën në Prishtinë duke kërkuar kushte më të mira të punës. “Qeveri - Kompani, është bërë vonë. Kthjelluni ose lamtumirë!”, ishte

mesazhi kryesor i pankartës që mbanin në duar punëtorët. Ndërkaq Partia Socialdemokrate (PSD) e akuzoi qeverinë për injorim të kërkesave dhe të të drejtave të punëtorëve. Federata Sindikale e Punëtorëve Teknikë bëri thirrje në Ditën Ndërkombëtare të Punëtorëve për rritje të pagës minimale,

## Kurti: Nuk do ta lejojmë krijimin e Republika Srpska në veri



PRISHTINË, 1 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se nuk do të lejojë krijimin e një forme të Republikës Srpska në veri të Kosovës. Këto komente Kurti i ka bërë në një intervistë për median kroate "Hina" në prag të një raundi të ri të dialogut për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Në takim të Kurtit me presidentin serb Aleksandar Vuçiq, në Bruksel më 2 maj, do të prezantohet drafti i statusit

të komunave në veri të Kosovës, që është një pikë kyçe e negociatave. "Duke pasur parasysh insistimin e Brukselit, do të jem i lumtur të shoh se çfarë drafti kanë përgatitur, edhe pse mendoj se do të ishte më mirë nëse do të ma prezantonin fillimisht në Prishtinë. Megjithatë, do të siguroj që ajo që është rënë dakord më 27 shkurt në Bruksel, është përmbushur ekzistimi i një niveli të duhur

të vetëqeverisjes së komunitetit serb sipas standardeve më të larta ndërkombëtare evropiane për mbrojtjen e minoriteteve. Por ajo që ne nuk do të lejojmë është e drejta e territorializimit dhe krijimit të çdo gjëje që do të dukej si Republika Srpska në BeH. Ne nuk do të lejojmë një parashtet satelitor me thelb shkatërrues që do ta minonte shtetësinë e Kosovës", ka theksuar Kurti.

## Tahiri: Modeli i statutit të Asociacionit do të ndikojë në funksionalitetin e shtetit të Kosovës dhe në fatin e kufijve në Ballkan

PRISHTINË, 1 MAJ - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka thënë se modeli i statutit të Asociacionit të cilin Kurti më 2 maj do ta negociojë me Vuçiqin në Bruksel do të ndikojë në funksionalitetin e shtetit të Kosovës dhe në fatin e

kufijve në Ballkan. Ajo ka shkruar në "Facebook" se ky model do t'i frymëzojë të gjitha pakicat në Ballkan, edhe më shumë shqiptarët në Maqedoninë e Veriut sepse, sipas saj, ata nuk janë pakicë atje, por janë gjysma e popullatës.



ato. Paga minimale mbetet e njëjtë. Pagë që nuk i del punëtorit me e kalu as gjysmën e muajit. E inflacionit qeveria iu përgjigj me manipulime të shifrave. Tha që i rriti pagat, e bankomati tregoi që u ndalën shtesat", kanë thënë zyrtarët e kësaj partie.

Sipas PSD-së, punëtori i Kosovës nuk ka sigurim shëndetësor e nuk është i siguruar nga rreziqet që sjellë tregu. "Aksidenti në punë apo edhe një sëmundje si kanceri ia rrezikon atij dhe familjes së tij ekzistencën. Përditshmëria e tij është ankthi i humbjes së punës dhe zhytjes në varfëri. Punëtori i Kosovës nuk po ia del me këto kushte të punës. Dhjetëra mijëra u larguan në dy vitet e fundit. Të tjerët do të vazhdojnë të neglizhohen nëse nuk organizohen. Kjo qeveri ka dëshmuar që është në gjatësi valore veç me të pasurit, veç me oligarkët. Andaj, ne jemi të bindur që klasa punëtore do të vazhdojë të shtypet e nëpërkëmbet nëse nuk organizohet në rezistencë", kanë deklaruar zyrtarët e kësaj partie. Sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, në tremujorin e parë të vitit 2022 papunësia në Kosovë është afër 17 për qind, një rënie në krahasim me vitin 2021 kur



shkalla e përgjithshme e papunësisë ishte mbi 20 për qind. Ndërkohë të punësuarit vazhdojnë të përballen me probleme të trashëguara si mungesa e sigurisë në punë dhe paga e ulët minimale, më e ulëta në Evropë, sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave, "Eurostat".

Kryeministri Albin Kurti me rastin e 1 Majit ka theksuar se si qeverisje e re kanë ndërmarrë një sërë hapash, vendimesh e iniciativash ligjore që prekin jetën e punëtorëve. "Kemi hartuar dhe dërguar në Kuvend

Projektligjin për Pagën Minimale, ligj që presim që Kuvendi ta miratojë sa më parë. Me qëllim shtimin e inspektimeve për zbatim sa më të mirë të ligjit të punës është ndarë buxheti për ta shtuar numrin e inspektorëve në terren. Ndërkohë që në buxhetin e këtij viti kemi paraparë 240 inspektorë shtesë në sektorë të ndryshëm. Gjatë këtyre dy viteve qeverisje kemi ndërmarrë masa që nxisin punësimin, me theks të veçantë punësimin e grave dhe të rinjve. Me masën 1.3, rreth 5 mijë gra më shumë janë

punësuar, ndërkaq përmes platformës 'Superpuna' kemi mbështetur punësimin e të rinjve, me ç'rast nga muaji shkurt janë realizuar 4 501 marrëdhënie pune përmes kësaj platforme (deri në çastin e këtij postimi)", ka deklaruar Kurti. Po ashtu, ai ka thënë se kanë rritur pagat në sektorin publik dhe përmes pakove të ndërmarra nga qeveria kanë mbështetur rritjen e pagave për 17 mijë punëtorë të sektorit privat. "Punësimi ka qenë një prej prioritetëve tona kryesore dhe së bashku me të esenciale

janë edhe të drejtat në punë", është shprehur Kurti.

Por njëjtë si Kurti nuk mendojnë dy liderët e opozitës, Memli Krasniqi dhe Ramush Haradinaj. Krasniqi ka thënë se si shtet e si shoqëri ende s'kemi arritur ta sigurojmë trajtimin meritot për çdo punëtor, në cilindo sektor që punon. "Për më shumë, sfidën e madhe të emigrimit masiv të të rinjve tanë që kërkojnë një perspektivë larg Kosovës, duhet ta tejkalojmë përmes angazhimit konkret për krijimin e një ambienti të favorshëm që ofron mundësi të barabarta, vende pune me paga konkurruese dhe vlerësim të drejtë për kontributin e punëtorëve", ka thënë Krasniqi. Lideri i AAK-së thotë se Dita Ndërkombëtare e Punës kësaj here Kosovën e gjen në pozitën më të rëndë në 24 vitet e fundit. "Secilën ditë që kalon, vendi ynë është edhe më keq, punëtorët tanë më të diskriminuar e qeveria edhe më e fjetur", është shprehur Haradinaj.

Ai ka thënë se kryeministri dhe kabineti i tij qeveritar janë të fokusuar më shumë në grumbullimin e parave në thesarin e shtetit sesa në investime kapitale, aty ku hapen vende të reja pune, rriten rrogat dhe zhvillohet shteti.

# 33 vjet nga Kuvendi i Verrave të Llukës të Pajtimit të Gjaqeve

33 vjet më parë, më 1 maj 1990, u mbajt kuvendi gjithëkombëtar i pajtimit të gjaqeve të Verrat e Llukës. Ky kuvend u organizua nga nismëtarët e pajtimit të gjaqeve 1990-1991 në Kosovë, Myrvete Dreshaj, Have Shala, Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj, në bashkëpunim me Këshillin e Pajtimit të Gjaqeve në Deçan. Atë e drejtuan Jashar Salihu dhe Have Shala. Në mbështetje të tyre, në binën madhështore do të gjenden Anton Çetta, Zekeria Cana, Dom Lush Gjergji, Mulla Idriz Kakrruki, Mujë Rugova, Ramiz Kelmendi...

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 1 MAJ** - Të hënën është shënuar 33-vjetori i Kuvendit të Verrave të Llukës të Pajtimit të Gjaqeve. Sado që ai u mbajt në rrethim të plotë nga forcat speciale policore serbe, të motorizuara dhe të blinduara, në kuvend morën pjesë mbi 500 mijë shqiptarë. Rezultati i

Meritorë për mbylljen e plagës shekullore të gjakmarrjes janë në radhë të parë të gjithë ata baballarë, nëna, vëllezër e motra, bashkëshorte, bijë e bija, që pa asnjë kompensim a kushtëzim të vetëm falën gjakun e më të dashurve të tyre dhe në emër të gjakut të derdhur të dëshmorëve, flamurit dhe Kombit, shtrinë dorën e pajtimit.



arritur: 106 pajtime, prej tyre 62 gjaqe, 25 plagë dhe 19 ngatërresa.

Kuvendi i Verrave të Llukës u organizua nga nismëtarët e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë, Myrvete Dreshaj, Have Shala, Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj, në bashkëpunim me Këshillin e Pajtimit të Gjaqeve në Deçan.

Atë e drejtuan Jashar Salihu dhe Have Shala. Në mbështetje të tyre, në binën madhështore do të gjenden Anton Çetta, Zekeria Cana, Dom Lush Gjergji, Mulla Idriz Kakrruki, Mujë Rugova, Ramiz Kelmendi, kurse vendi i nderit do t'i jepej nënës së pishtarëve të lëvizjes sonë çlirimtare kombëtare, heronjve të Kosovës, Jusuf e Bardhosh Gërvalla, Ajshe Gërvalla.

Pa Kuvendin e Verrave të Llukës të 33 vjetëve më parë, përgjithësisht pa Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë në vitin 1990, përmes së cilës u arrit falja e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave, çmimi që do të paguanin shqiptarët për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës do të ishte shumëfish më i lartë.

Këtë përvjetor e ka kujtuar Adem Grabovci, një nga nismëtarët e Pajtimit të Gjaqeve. "Para 33 vjetësh, më 1 maj 1990, së bashku me nismëtarët e Pajtimit të Gjaqeve, nga rinia studentore dhe në bashkëpunim të ngushtë me bashkëveprimtarët e tjerë, organizuam tubimin për faljen e gjaqeve të Verrat e Llukës. Mbi 100 gjaqe, plagë dhe ngatërresa të tubuar, ky ishte epilogu i atij



tubimi madhështor. Ata që duan të të pushtojnë, të të dobësojnë, të të shfrytëzojnë, gjithnjë kërkojnë plagën tënde të brendshme në mënyrë që lehtësisht të jesh i nënshtruar në fillim fizikisht e pastaj psikikisht dhe shpirtërisht. Përkushtimi ynë më i rëndësishëm ishte mbyllja e kësaj plaje në mënyrë që të rrugëtojmë të bashkuar", ka thënë Grabovci.

Ai ka shtuar se ky tubim e çoi edhe një hap më tej unifikimin e popullit tonë që po arrihej dhe forcohej çdo ditë përmes pajtimit të gjaqeve, duke krijuar kështu parakushtet e domosdoshme dhe terrenin e përshtatshëm për formimin e UÇK-së, lufta e së cilës, si kurorëzim i të gjitha përpjekjeve dhe sakrificave të gjeneratave të tëra të popullit tonë, solli çlirimin, lirinë, pavarësinë dhe shtetin e Kosovës. "Në punën tonë prej nismëtarësh të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve, ndonëse të një moshe të re, nuk na mungonte guximi i shfaqjes së mendimit, por na mungonte gojëtaria e artikullimit të atyre mendimeve. Kur ne i trokitëm për herë të parë në derë profesor Antonit (janar 1990) dhe i treguam për misionin tonë, befasia i shihej në sytë e tij, por edhe krenaria për ne dhe punën

tonë. Për kohën duhej guxim dhe vendosmëri e pamohueshme për të na përkrahur", thotë Myrvete Dreshaj-Baliu.

Ajo ka theksuar se "E kush dinte më mirë se profesor Anton Çetta që faljen e gjakut ta kërkonte në emër të dëshmorëve, të gjakut të tyre, në emër të popullit, të flamurit, të rinisë, në emër të unitetit kombëtar".

Dreshaj-Baliu ka theksuar se nga këndvështrimi kontrastiv i rrafshëve të komunikimit, funksionet e të folurit në odë në gojëtarinë e Anton Çettës kishin edhe vlerën e bartësit të edukimit, rolin përafres, bashkues e drejtues dhe përmasat shprehëse e përmbuluese të një institucioni autonom e afirmativ, të cilin tashmë e kishte krijuar Aksioni i Pajtimit të Gjaqeve. "Në këtë rrafsh unë identifikova këtu vetëm gojëtarinë e profesor Anton Çettës gjatë Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve, ku roli i tij ishte i pazëvendësueshëm. Format e tjera të kontributit të tij në fushë të gojëtarisë sigurisht do të donin një qasje dhe një trajtesë tjetër", ka thënë Dreshaj-Baliu. Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se sot në këtë 33-vjetor kujtojmë dhe nderojmë me respekt gjithë ata

burra e gra, djem e vajza, intelektualë e patriotë, studentët e asaj kohe, klerikët fetarë, profesorët e atdhetarët e tjerë, të prirë nga burri i urtë, i mençur, prof. Anton Çeta, bashkë me profesorin Zekeria Cana e veprimtarë të tjerë, që i prinë kësaj lëvizjeje mbarëkombëtare të pajtimit të popullit tonë. "Ky kuvend, i cili ishte vazhdimësi e shumë kuvendeve të mbajtura të Verrat e Llukës në fund të shekullit IX dhe gjatë shekullit XX, mbetet një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe më të lavdishme të historisë së kombit tonë!", ka shkruar Ramosaj në "Facebook".

33-vjetorin e Kuvendit të Verrave të Llukës të Pajtimit të Gjaqeve e ka kujtuar edhe lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili ka thënë se kjo lëvizje popullore, në krye me profesorin dhe atdhetarin Anton Çetta, u bë pikë kthese për bashkimin e unitet mbarëshqiptar, duke i dhënë fund gjakmarrjes, vëllavrasjes dhe ngatërresave mes vete, për t'u mbledhur rreth një qëllimi më madhor e jetik, që ishte lufta për liri. "Mirënjohje e përjetshme për të gjithë ata veprimtarë, patriotë e intelektualë, që u bënë bashkë për Kosovën në këtë nismë për paqe vëllazërore!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".



## ASK-ja: Në tre muajt e parë të këtij viti u hapën mbi 3 000 biznese

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Repertorin Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë për tremujorin e parë (TM1) 2023. Në TM1 2023 gjithsej janë regjistruar 3 086 ndërmarrje që, krahasuar me tremujorin paraprak (TM4 2022), ka një ngritje për 17.07 % të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM1 2022), ka një rritje për 9 % të ndërmarrjeve të regjistruara.

Aktivitetet ekonomike më të pëlqyera gjatë këtij tremujori ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike, motoçikletave me 762 ndërmarrje të regjistruara (24.7%); Prodhimi me 353 ndërmarrje të regjistruara

(11.4%); Ndërtimtaria me 325 ndërmarrje të regjistruara (10.5%); Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 309 ndërmarrje të regjistruara (10 %); Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim me 271 ndërmarrje të regjistruara (8.8 %) etj.

Ndërkaq sipas kategorisë së të punësuarve në ndërmarrjet e regjistruara në këtë tremujor, ishin: në kategorinë me 1 deri në 4 të punësuar janë gjithsej 2 988 ndërmarrje të regjistruara (96.8%); në kategorinë me 5 deri 9 të punësuar janë 69 sosh (2.2 %); në kategorinë me 10 deri në 19 të punësuar janë 19 ndërmarrje të regjistruara (0.6 %); me 20 deri 249 të punësuar janë 9 ndërmarrje të regjistruara (0.3%); ndërsa në kategorinë me 250 e më shumë të punësuar është vetëm 1 ndërmarrje e regjistruar.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të



ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave prin komuna e Prishtinës me 862 ndërmarrje të regjistruara (27.9 %); Ferizaj me 267 ndërmarrje të regjistruara (8.6

%); Prizreni me 261 ndërmarrje të regjistruara (8.4 %); Gjilani me 172 ndërmarrje të regjistruara (5.6 %); Peja me 160 ndërmarrje të regjistruara (5.2 %); dhe Fushë-

Kosova me 124 ndërmarrje të regjistruara (4 %). Komunitat e tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në këtë tremujor.

## Azemi: As kjo qeveri nuk bëri asgjë për punëtorët e sektorit privat



PRISHTINË, 1 MAJ - Jusuf Azemi, kryetar i Sindikatës së Sektorit Privat të Kosovës, ka thënë se nga këndi sindikal thonë se koha e demagogjive ka përfunduar. Azemi e ka kundërshtuar kryeministrin Kurti lidhur me 1 Majin, duke thënë se "t'i thuash dikujt se kemi shtuar vende të punës, kemi krijuar kushte më të mira për punëtorët të sektorit privat të Kosovës, mund edhe 'ta hajë pazari'". "Por ne jemi këtu çdo ditë dhe disa herë kemi kërkuar, edhe sot kërkuam, që disa premtime që i kanë bërë gjatë fushatës, a mund të dalë dikush të thotë se një ose këtë e kemi

realizuar", ka thënë ai. Ai ka shtuar se e dinë që të gjitha premtimet e fushatës nuk mund t'i realizojnë por, sipas tij, duhet të japin arsyen se pse nuk po realizohen. Sipas tij, ofrimi i kushteve më të mira për punëtorët e sektorit privat nga kjo qeveri dhe nga qeveritë e tjera është "e barabartë me zero". "Te punëtorët e sektorit privat të Kosovës kjo qeveri e ka rritur ironizimin sepse gjatë kësaj periudhe punëtorët e sektorit publik ishin dhe janë në një pozitë më të mirë se ne edhe me paga dhe me mbështetje, subvencione", ka deklaruar ai në emisionin "FIVE".

## Falimenton edhe një tjetër bankë e madhe amerikane

WASHINGTON, 1 MAJ - Korporata Federale e Sigurimit të Depozitave (FDIC) e konfirmoi të hënën, më 1 maj, se banka e madhe amerikane, "First Republic", ka falimentuar. Gjiganti bankar i investimeve, "JP Morgan Chase", do ta marrë përsipër tani këtë bankë. Sipas marrëveshjes së ndërmjetësuar nga rregullatorët, "JP Morgan Chase" do t'i marrë përsipër të gjitha depozitat dhe shumicën e aksioneve të bankës "First Republic".

"First Republic" është banka e tretë amerikane që ka falimentuar gjatë muajve të fundit, gjë që ka nxjerrë shqetësimet për një krizë më të gjerë bankare.

Aksionet e bankës me seli në San Francisco ranë për më shumë se 75 për qind javën e kaluar pasi ajo pranoi se klientët kishin tërhequr 100 miliardë dollarë gjatë muajit mars.

Falimentimi i "First Republic" vjen pas kolapsit të "Silicon Valley Bank" (SVB) në mars dhe rënies



së një huadhënësi tjetër amerikan "Signature Bank".

Në përpjekje për ta shpëtuar bankën "First Republic", zyrtarët amerikanë u raportua se kishin kontaktuar gjashtë banka të ndryshme, sipas agjencisë së

lajmeve AFP.

Jamie Dimon, shef ekzekutiv i "JP Morgan Chase", tha se qeveria e kishte "ftuar" gjigantin bankar, së bashku me të tjerë, ta merrnin situatën në duar "dhe ne e bëmë". Ai shtoi se blerja do të sillte

"përfitime modeste" për firmën dhe do të ishte pjesë "plotësuese" e firmës aktuale.

Si pjesë e marrëveshjes, FDIC do t'i ndajë humbjet nga huat me "JP Morgan". 84 zyrtarë e bankës së dështuar në tetë shtete të

ndryshme do të rihapen si degë të JP "Morgan Chase Bank" nga 1 maji, pasi rregullatorët morën kontrollin e saj dhe ia shitën menjëherë institucionit të "Wall Street".

Tërheqja e depozitave nga disa huadhënësit gjatë muajve të fundit e ka detyruar Rezervën Federale, bankën qendrore të ShBA-së, të ndërhyjë me masa urgjente për t'i stabilizuar tregjet financiare.

Në mars, një grup i bankave më të mëdha të Amerikës i grumbulluan së bashku 30 miliardë dollarë për "First Republic" në një përpjekje për ta stabilizuar atë, por përpjekjet rezultuan të kota.

E themeluar në vitin 1985, "First Republic" është një huadhënëse amerikane e madhësisë së mesme, e ngjashme me "Silicon Valley Bank". Për vite me radhë ajo u ka shërbyer klientëve të pasur - paratë e të cilëve ishin në rrezik përpara se marrëveshja të shpallej pas një fundjave negociatash.

# Gardhet që ndajnë Evropën

Nga María MARTÍN & Silvia AYUSO & Jolanda CLEMENTE

Fantazma e mureve po e përndjek sërish Evropën. Tre dekada pas rënies së Murit të Berlinit, rishfaqet sërish pyetja: A duhet të ngrëjë Bashkimi Evropian barriera për të mbrojtur kufijtë e tij të jashtëm? Realiteti është se unioni po e bën tashmë këtë gjë.

Gjatë 8 viteve të fundit shtetet anëtare kanë ndërtuar më shumë se 1700 kilometra mure për të mbrojtur veten jo kundër tankeve apo ushtarëve, por kundër emigrantëve dhe refugjatëve.

Por kush po paguan për to? A duhet që fondet evropiane të financojnë barrierat prejçimentoje, çelikut dhe telit me gjemba në të njëjtën mënyrë siç financojnë blerjen e radarëve dhe dronëve?

Debati është i zjarrtë, por përfundimet e takimit të fundit të Këshillit Evropian më 9 shkurt, sugjerojnë se po fitojnë terren ata që mbështesin një qasje më të ashpër ndaj emigrantëve. Duke filluar nga viti 2015, shumë vende nisën të ndërtojnë mure, sidomos në Ballkan për të penguar hyrjen e emigrantëve nga Siria, Iraku dhe zona të tjera në konflikt.

Komisioni Evropian, dhe vende si Spanja dhe Gjermania, janë kundër përdorimit të parave të BE-së për të ndërtuar më shumë mure. Ata besojnë se ekzistojnë mjete më efektive për të frenuar emigracionin e parregullt.

Por ata që janë në favor të tyre, të kryesuar nga grupi i Vishegradit i përbërë nga Republika Çeke, Polonia, Sllovakia dhe Hungaria dhe të mbështetur nga Italia, Greqia dhe Austria, e argumentojnë pozicionin e tyre duke përdorur një lloj logjike të brendshme: që të jemi në gjendje të mbyllim dyert, ato duhet së pari ato të ekzistojnë.

Tundimi për të ndarë botën në parcela tokësore dhe detare, ka qenë gjithnjë i pranishëm në Bashkimin Evropian. Ai është formësuar duke eliminuar kufijtë e brendshëm dhe duke forcuar ata të jashtëm. Nervozizmi në lidhje me këta kufij të jashtëm rishfaqet rregullisht. Takimi i fundit i Këshillit Evropian, është një shembull, ndërsa episodi i mëparshëm ishte pak më shumë se një vit më parë, kur në tetorin e vitit 2021 ministrat e brendshëm të 12 vendeve i shkruan një letër Komisionit Evropian, duke kërkuar që të jetë prioriteti studimi se si të financohet ndërtimi i “pengesave fizike” për kufijtë e jashtëm.

Këto të fundit kanë mbrojtur për dekada një pjesë të kufirit të jashtëm të Evropës. Enklava spanjolle Ceuta në Afrikën e



Veriut (1993) dhe Melila (në vitin 1996), ishin ndër të parat që u ngritën. Më pas, këto barriera janë zgjeruar për të mbuluar më shumë se 2000 kilometra.

Për shembull Bullgaria, vendi më i varfër në BE, ka një gardh që shtrihet në rreth 98 për qind të kufirit të saj me Turqinë.

Kriza e refugjatëve e vitit 2015, me ardhjen e më shumë se 1 milion njerëzve – shumë prej tyre të ikur nga lufta në Siri – solli një shtysë të re për të ndërtuar mure për të ndaluar ata që përpiqeshin të hynin në kontinent. Gardhet u shtuan në Hungari, Letoni, Slloveni, Austri, dhe madje edhe në Francë.

Vite më vonë, kur emigracioni ra në nivele relativisht të ulëta, Evropa pa sesi partnerët dhe fqinjët e përdorën çështjen e emigracionit si një armë për të destabilizuar kontinentin dhe për të kërkuar lëshime. Kjo ndodhi në vitin 2020, kur Turqia hapi kufijtë e saj dhe e kërcënoi Evropën me ardhjen e miliona refugjatëve, dhe kur Maroku lejoi më shumë se 10.000 njerëz të kalonin në Ceuta në majin e vitit 2021.

Episodi i fundit, i përshtatur në terma luftarakë si një “kërcënim hibrid”, ndodhi në verën dhe vjeshtën e vitit 2021, kur Bjellorusia inkurajoi dhjetëra mijëra njerëz të hynin në Poloni, Lituani dhe Letoni gjatë krizës kufitare Bjellorusi-Bashkimi Evropian 2021-2022.

Përgjigja ishte ndërtimi ose

zgjerimi i mureve qindra kilometra të gjatë midis 3 vendeve dhe Bjellorusisë. Tani, lufta në Ukrainë ka ringjallur në disa vende frikën se Moskë po e përdor emigracionin si një armë shtesë në arsenalin e saj kundër Evropës.

Finlanda ka njoftuar tashmë planet për të ndërtuar një gardh në kufi me Rusinë, duke qenë se ka kufirin më të gjatë nga të gjitha shtetet me atë që është vendi më i madh në botë për nga sipërfaqja. Bashkimi Evropian nuk ngurron të investojë shumat të mëdha parash për të frenuar flukset migratore.

Si shembull është fondi prej 6.7 miliardë eurosh, që Komisioni ka caktuar për menaxhimin e kufijve në vitet 2021–2027. Por deri më tani, pagesa për muret prej çeliku dhe me tela me gjemba ishte një temë tabu. Direktiva evropiane është e paqartë dhe megjithëse disa burime të BE-së thonë se nuk do të kishte asnjë pengesë ligjore për financimin e barrierave fizike, Komisioni sërish ngurron.

Ndërkaq, muret po e ndajnë tashmë Evropën edhe ideologjikisht. Presidentja e KE, Von der Leyen ndryshon nga linja e ndjekur nga familja e saj politike, Partia Popullore Evropiane (EPP), një nga mbështetësit kryesorë të ndërtimit të gardheve. Por sipas burimeve të BE-së, refuzimi i Komisionit për të ndarë fonde evropiane për ndërtimin e tyre

është gjithashtu një pozicion pragmatik.

Ngritja e mureve mijëra kilometra të gjatë do të kushtonte jo pak para, të cilat mund të shpenzohen për projekte të tjera. Për shembull, Brukseli beson se është shumë më efikase që ato të investohen në marrëveshje me vendet e origjinës së emigrantëve të parregullt, në mënyrë që të pranojnë kthimin e shtetasve të tyre.

Argumentet e atyre që kundërshtojnë muret janë të ngjashme: janë të kushtueshme, përçarëse, dhe jo vetëm që nuk i pengojnë njerëzit t'i kapërcejnë ato, por nxitin gjithashtu krijimin e rrugëve të reja, më të gjata, më të kushtueshme dhe më të rrezikshme, duke prodhuar dy fitues të qartë: kompanitë që i ndërtojnë, dhe trafikantët që i anashkalojnë.

“Muret dhe barrierat funksionojnë rrallë aq mirë sa shpresohet” – thotë Klaus Dods, profesor i gjeopolitikës në Universitetin “Royal Holloway” në Londër dhe autor i librit “Luftërat kufitare: Konfliktet e së nesërme”. “Ato nxitin ankesa dhe zemërimi që ekziston mes emigrantëve dhe u japin shpresa të rreme komuniteteve lokale” – thekson ai.

Ekspteri beson se ato marrin “një rëndësi simbolike të ekzagjeruar” dhe shton se “ndërsa qeveritë duan të shihen nga publiku se po bëjnë diçka, për komunitetet që

jetojnë në të dy anët e një kufiri, siç është zona kufitare SHBA-Meksikë, situata mund të jetë e ndërlikuar, pasi familjet dhe komunitetet kanë lidhje me të dyja anët, dhe muri vepron si një plagë që nuk shërohet”.

Edhe Gil Arias, ish-drejtor ekzekutiv i Frontex, është skeptik kur flitet për gardhet. “Pengesat fizike nuk kanë qenë kurrë një pengesë radikale. Ne e kemi parë këtë në Ceuta dhe Melillandër vite” – shprehet ai. Arias beson se kufijtë duhen mbrojtur me inteligjencë dhe jo me tela me gjemba.

Ndërkohë, muret sjellin pasoja të drejtpërdrejta në lidhje me respektimin e të drejtave dhe dinjitetit të emigrantëve dhe aftësisë së tyre për të kërkuar azil, kur ata ikin nga luftërat dhe konfliktet. Për shkak të tyre kanë ndodhur shumë tragjedi, disa prej tyre në Spanjë.

E fundit dhe më e rënda ishte 24 qershori i vitit kaluar, kur të paktën 23 persona humbën jetën në përpjekje për të kaluar kufirin nga Nador në Melilla. Debati mbi të nuk do të marrëfund lehtë. Për profesor Dods, ekziston rreziku që muret dhe gardhet vetëm sa “do të ndezin më tej pasionet”, dhe do të vazhdojnë të shtyjnë debatet që janë më urgjente mbi vendbanimin afatgjatë të komuniteteve nga e gjithë bota, të cilët të prekur nga lufta, fatkeqësitë natyrore dhe ngrohja globale.

**Marrë me shkurtime nga “El Pais” – Bota.al**



# Dy jetët e Garry Kasparovit



Jeta e Garry Kasparov, që më 13 prill mbushi 60 vjeç, mund të ndahet në dy pjesë: E para është ajo e kampionit të shahut, ndoshta më madhështorja. E dyta është ajo e një aktivisti politik, që pasi u tërhoq nga shahu, luftoi dhe lufton ende për të kundërshtuar regjimin autoritar të Vladimir Putinin në Rusi.

Dy jetët, ajo e kampionit dhe ajo e disidentit, janë të lidhura me njëra-tjetrën, por në të njëjtën kohë janë shumë të dallueshme: si kampion bote në shah, Kasparov u nderua fillimisht nga Bashkimi Sovjetik dhe më pas nga Rusia, ku përfitoi famë dhe pasuri. Si disident, Kasparov u detyrua të largohej nga vendi – sot jeton në Kroaci – u arrestua më shumë se një herë dhe u frikësua për jetën e tij.

Garry Kasparov lindi në Baku, në kryeqytetin e Azerbajxhanit më 13 prill 1963. Babai i tij, Kim Weinstein, ishte hebre, ndërsa nëna e tij, Klara Kasparova, ishte armene. Talenti i Kasparov u vu re që në moshë të vogël. Ai u përfshi në rrjetin e gjerë të shkollave dhe akademive kushtuar shahut në të gjithë Bashkimin Sovjetik.

Në atë kohë, shahu ishte një çështje krenarie kombëtare dhe konkurrencë intelektuale e sportive me Shtetet e Bashkuara. Ndaj lojtarët më të mirë mbështeteshin dhe subvencionoheshin nga shteti. Kur ai ishte shtatë vjeç, Kim Weinstein, vdiq papritur. Në moshën 12-vjeçare Kasparov ishte tashmë një lojtar i njohur në shkallë kombëtare, dhe me këshillën e mjeshtrit të tij të shahut, ish-kampionit botëror Mikhail Botvinnik, ai vendosi të merrte mbiemrin e nënës së tij.

Sepse pasja e një mbiemri hebre si Weinstein mund të ishte një pengesë për karrierën e tij në një vend ende shumë antisemit si Rusia. Kasparov u bë kampion bote për të rinjtë në vitin 1980. Në vitin 1981 ai u bë kampion kombëtar, dhe në vitin 1984 luajti finalen e tij të parë të kampionatit botëror kundër Anatoli Karpov, kampioni i atëhershëm, që po ashtu ishte sovjetik.

Ishte një finale historike. Sipas rregullave të kohës, lojtari i parë që do të fitonte 6 ndeshje pa llogaritur barazimet do të shpallej kampion. Por për 48 ndeshje asnjëri prej tyre nuk arriti të dominonte ndaj tjetrit. Finalja (me pushime të ndryshme mes ndeshjeve) zgjati 6 muaj, nga shtatori 1984 deri në shkurt 1985.

Në fund, të dy lojtarët ishin të rraskapitur fizikisht. Që nga fillimi i kampionatit, Kasparov kishte humbur më shumë se 10 kilogramë. Në atë moment, në një vendim të padëgjuar që nuk u përsërit kurrë më pas, presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Shahut, Florencio Campomanes vendosi të ndërpresë finalen pa shpallur një fitues.

Në fund Karpov kishte fituar 5 ndeshje dhe Kasparov 3 (përfshirë dy 2 fundit), dhe 40 ndeshje përfunduan barazim. Gjithsesi, finalja e vitit 1984 ishte momenti kur Kasparov u bë

i famshëm në botë. Ndërsa Karpov ishte një lojtar i shkëlqyer, por një mjeshtër i mbrojtjes, duke luajtur në një stil të përgjithshëm të parashikueshëm, Kasparov ishte një lojtar i guximshëm, duke bërë sulme të guximshme

dhe duke luajtur shah në një mënyrë emocionuese dhe të vrullshme.

Ndër të tjera, finalja u pa si një alegori politike, edhe për shkak të personalitetit të dy shahistëve: Karpov shihej si një burokrat besnik i regjimit sovjetik, ndërsa Kasparov, më i riu, u prezantua nga mediat si një rebel dhe një novator. Ai vetë kishte treguar në më shumë se një rast përbuzje ndaj klasës sunduese sovjetike të atyre viteve, edhe pse nuk kreu kurrë akte rebelimi të hapura, dhe do të mbetej anëtar i Partisë Komuniste Sovjetike deri në vitin 1990.

Në kampionatin botëror 1985, Kasparov fitoi duke treguar shumë shkathhtësi. Kështu nisi një nga dominimet më të gjata në historinë e kësaj loje. Ai mbeti kampion deri në vitin 2000, edhe pse një moment ai dhe të tjerët u shkëputën nga Federata Ndërkombëtare e Shahut, duke krijuar një ligë të re.

Kasparov konsiderohet si një nga shahistët më të mirë që ka jetuar ndonjëherë, në mos më i miri nga të gjithë. Megjithatë, ai është i famshëm edhe për një tjetër episod. Në vitin 1996 luajti një ndeshje historike kundër super-kompjuterit “Deep Blue” dhe u bë kampioni i parë në fuqi i botës që u mposht nga një pajisje artificiale.

Ajo ndeshje konsiderohet një moment themelor në historinë e zhvillimit të Inteligjencës Artificiale. Kasparov humbi titullin e tij si kampion bote në vitin 2000, dhe megjithëse vazhdoi të luante shah profesionalisht për disa vite, interesat e tij gradualisht filluan të ndryshojnë.

Në ato vite, Presidenti Vladimir Putin po konsolidonte pushtetin e tij brenda Rusisë dhe po tregonte tashmë të gjithë elementët e asaj që do të bëhej regjimi i tij autoritar. Kasparov, që ishte një personazh publik i klasit të parë në Rusi, i njohur dhe i admiruar në të gjithë botën, u bind se nevojitej veprim për t’iu kundërvënë autoritarizmit në rritje të Putinin.

Pasi u tërhoq zyrtarisht nga shahu profesionist në vitin 2005, ai njoftoi themelimin e Frontit të Bashkuar Civil, një parti opozitare që synonte “ruajtjen e demokracisë në Rusi”. Rreth vitit 2007 ai nisi të organizojë dhe udhëheqë demonstrata të mëdha kundër Putinin, të njohura si “Marshimet e disidentëve”, të cilat u shtypën me shpejtësi nga policia.

Ai u arrestua disa herë dhe u lirua menjëherë. Në vitin 2008, doli si kandidat në zgjedhjet presidenciale. Por fushata e tij elektorale u bojkotua sistematikisht nga autoritetet ruse, duke çuar në dështim. Pas disa muajsh shumë të vështirë, Kasparov hoqi dorë nga kandidatura dhe u tërhoq. Zgjedhjet u fituan nga Dmitri Medvedev, një aleat i ngushtë i zgjedhur personalisht nga Putini, i cili nuk mundi të kandidonte sërish, sepse kishte shërbyer tashmë 2 mandate radhazi si president. Në fund të sundimit 4-vjeçar të Medvedevit, Putin kandidoi sërish për presidencën dhe në atë moment pakënaqësia e popullatës ruse u bë e pakontrollueshme.

Në fund të vitit 2011 dhe për një pjesë të mirë të vitit 2012,

protesta të mëdha kundër regjimit u mbajtën në të gjithë Rusinë dhe sidomos në Moskë. Kasparov u bë një nga udhëheqësit e atyre demonstratave, tërë cilat vazhduan pandërprerë për muaj të tërë.

Me të u bashkuan një klasë krejtësisht e re liderësh opozitarë, përfshirë Boris Nemtsov, i cili kishte qenë zëvendëskryeministër nën presidentin Boris Yeltsin dhe blogerin kundër korrupsionit Alexei Navalny. Megjithatë, përgjigja e Putinin ishte e ashpër. Protestat u shtypën me dhunë dhe qindra njerëz u gjykan me akuza shumë të rënda.

Drejtuesit e opozitës në atë kohë pësuan një persekutim të jashtëzakonshëm. Navalny u burgos me akuza të rreme. Boris Nemtsov u vra në vitin 2015 në Moskë. Kasparov u arrestua dhe u rrah nga policia në vitin 2012, teksa merrte pjesë në një demonstratë në favor të grupit punk, Pussy Riot.

Një vit më pas, u largua nga Rusia. Dhjetë vitet e fundit ai ka vazhduar ta kundërshtojë Putinin nga mërgimi, por në Rusi figura e tij e ka humbur gradualisht popullaritetin. Gjithsesi ai mbetet një nga intelektualët më të rëndësishëm rusë në botë, mendimi i të cilit ndiqet gjerësisht veçanërisht në Perëndim.

Vitin e kaluar, menjëherë pas pushtimit rus të Ukrainës, ai shkroi në Twitter: “Mënyra e vetme për t’i dhënë fund kësaj lufte, është rrëzimi i regjimit të Putinin përmes kolapsit të ekonomisë ruse dhe humbjes në Ukrainë. Çdo opsion tjetër do të thotë shtyrje deri në krizën tjetër”. / “Il Post” – Bota.al

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Invert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## Peja mundet në finale të Ligës Ballkanike

PEJË, 1 MAJ - Peja ka luftuar, por nuk arriti që të shpallet kampione e Ligës Ballkanike. Pejanët pësuan nga Hapoel Beer Sheva me rezultat 99:95 (31:20, 28:33,

16:25, 24:17). Izraelitët e nisën më mirë ndeshjen, duke e fituar çerekun e parë 31:20, por kundërpërgjigja e verdhezinjëve nuk vonoi

shumë, ku shkuan në pushim me rezultat 59:53. Skuadra kosovare vazhdoi me lojë të mirë edhe në periudhën e tretë, ku bënë përmbysjen, ndërsa shifrat

pas 30 minutash ishin 75:78. Dy minuta nga fundi rezultati ishte 91:91, por më pas Hapeol ishte më i vëmendshëm në fund dhe fitoi 99:95.



# Kosova përfundon kualifikimet për 'Euro 2024'



PRISHTINË, 1 MAJ - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll i ka përfunduar kualifikimet për "Euro 2024". Ndashjen e fundit Kosova e luajti të dielën mbrëma në Velenje. U mposht nga

Slovenia me rezultat 33:28. Pas pjesës së parë rezultati ishte 19:12 për slovenët. Në periudha, Kosova ka shfaqur ndeshje të mirë dhe ka shënuar gola të bukur. Por në përgjithësi cilësia e

lojtarëve slovenë e bëri dallimin. Gjatë këtij cikli kualifikues Kosova ka shfaqur hendboll të mirë në disa prej ndeshjeve. Por grupi ishte i fortë, me Kombëtare cilësore. Prej

grupit të shtatë në Evropian janë kualifikuar Slovenia, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi. Ndash Slovenisë, Valon Dedaj i kishte tetë gola nga nëntë tentime, ndërsa Leonard Gegaj shënoi shtatë

gola nga nëntë tentime. Liridon Zena i kishte dhjetë pritje. Lulzim Shabani shënoi katër gola nga katër tentime, derisa katër gola nga tetë tentime i kishte Drenit Tahirukaj.

## Kumbulla: Do të rikthehem edhe më i fortë



ROMË, 1 MAJ - Marash Kumbulla është i pafat, pasi ka pësuar një tjetër lëndim dhe kësaj radhe më të rëndë. Qendërmbrojtësi shqiptar u lëndua në derbin e Serie A mes Romës dhe Milan dhe do t'i mungojë skuadrës kryeqytetase për pjesën e mbetur të sezonit. Përveç që nuk do të luaj më me Romën këtë edicion, Kumbulla ka

humbur edhe dy sfidat e muajit qershor me Shqipërinë atë ndaj Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Reprerentuesi shqiptar ka reaguar nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, aty ku thekson se do të rikthehet më i fortë se më parë. "Sezoni nuk shkoi siç do të kisha dashur dhe u mbyll në mënyrën më të keqe të mundshme. Jam shumë i

zhgënjyer, do të më duhet kohë për t'u shëruar. Do ta shfrytëzoj këtë kohë për t'u rikthyer edhe më i fortë dhe për të ndryshuar gjërat, ju siguroj. Faleminderit të gjithëve për mesazhet. Daje Roma", ka shkruar Kumbulla. 23-vjeçari këtë edicion ka zhvilluar vetëm 12 ndeshje me Romën ku ka edhe një gol të shënuar.

## Ukraina bojkoton Botërorin e xhudos për shkak të atletëve rusë

Kiev, 1 maj - Xhudistët ukrainas nuk do të marrin pjesë në Kampionatin Botëror të Xhudos të këtij muaji në Katar, pas vendimit të Federatës Ndërkombëtare të Xhudos (IJF) për të pranuar rusët dhe bjellorusët si neutralë, ka thënë Federata e

Xhudos e Ukrainës. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) muajin e kaluar rekomandoi që atletët nga të dy vendet të lejohen të kthehen në garat ndërkombëtare si sportistë neutralë. IJF javën e kaluar njoftoi se do të lejojë

xhudistët nga Rusia dhe Bjellorusia të marrin pjesë në kampionatin e 7-14 majit, duke thënë se vendimi i saj do të lejojë rusët dhe bjellorusët të marrin pjesë në kualifikimet për Lojërat Olimpike 2024 në Paris. Rekomandimet e IOC

përjashtojnë atletët që mbështesin luftën ose janë të kontraktuar me agjencitë ushtarake ose kombëtare të sigurisë. IJF ka thënë se ka angazhuar një kompani të pavarur për të kryer kontrollin dhe për të identifikuar ndonjë atletë të tillë.



## Thirrje për aplikim

**Fidan Krasniqi BI SHPK – Perfaqesuar nga Fidan Krasniqi**, po kërkon ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë / propozim për:

“Pjesa elektronikë dhe automatikë e sistemit të mjeljes 2x6, Pedometer, paisje që vendoset tek gjedhet, regjistron dhe percjell në databazë në kohë reale të dhenat, Ventilator me dimater minimumi 1 m”

**Nr. Prokurimit: FK 01-2023**

**Emri: Fidan Krasniqi BI SHPK**

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: [fidan.krasniqi@gmail.com](mailto:fidan.krasniqi@gmail.com)

Adresa: Rr. Halim Ahmetaj 3/A, Prizren

Tel: +383 (0) 49 903 855

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, **ora 14:00**, në Adresa: Rr. Halim Ahmetaj 3/A, Prizren.

## Thirrje për aplikim

“N.SH. Etno Fruits”- Merita Mehmeti, po kërkon ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

“Set sistemi për mbrojtje nga breshëri (Sistem italian kundër breshëri), përfshi stubat nga betoni me ankerat, lidhëset, rrjetat mbrojtëse etj.”

**Nr. Prokurimit: Etno Fruits 01-2023**

**Emri: N.SH. “Etno Fruits”**

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: [Meritame@gmail.com](mailto:Meritame@gmail.com)

Adresa: **Fshati Llabjan, Novobërdë**

Tel: +383 (0) 45 618 885

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, **ora 14:00**, në Adresa: Fshati Llabjan, Novobërdë



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të

volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

MEKA  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues